



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE - KOMUNA E DRAGASHIT
EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE -OPŠTINA DRAGAŠ**

EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE - DRAGASH MUNICIPALITY

RREGULLORE

**Mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores mbi lartësinë e
taksave,ngarkesave dhe gjobave komunale**

Dragash,31.05. 2016

Në bazë të nenit 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-040,)nenit 10 të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-049),nenit 32 pika 2 e Statutit të Komunës së Dragashit,Kuvendi i Komunës së Dragashit ,në seancen e mbajtur më 31.05.2016, miraton këtë:

RREGULLORE

MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES MBI LARTËSINË E TAKSAVE NGARKESAVE DHE GJOBAVE KOMUNALE

Neni 6 i Rregullores mbi Taksat,Ngarkesat dhe Gjobat komunale 01 Nr-06-15345/1 prej 28.08.2014 ndryshohet në tersi dhe pas tijë shtohen nenet me këtë përmbajtje

Neni 6a

Të gjitha bizneset individuale të cilat janë të regjistruara dhe do të regjistrohen në regjistrin e bizneseve në intervalin kohor prej 01.01.2016 deri me 31.12.2018 do të lirohen nga obligimi I pagesës së taksave komunale në firmë të përcaktuara me skemën tarifore 01-nr.117/1.të Rregullores bazë.

Neni 6b

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjherë pas miratimit të saj nga Kuvendi Komunal, ndersa do të aplikohet nga 1 janari 2016.

Neni 6c

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren mbi ndryshimin dhe plotesimin e Rregullores mbi taksat ,ngarkesat dhe gjobat komunale 01/nr.06-649/1 prej 03.05.2012.

01 Nr.06-8491/1

Data 31.05.2016



KRYESUESI I KUVENDIT

SHABAN SHABANI